

**VENDIM**  
**Nr.1051, datë 23.10.2009**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.802, DATË 22.7.2009 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT RAJONAL TË STUDIMIT**  
**“MASTER NË “EU BUSINESS LAW””, NË FAKULTETIN E DREJTËSISË, TË**  
**UNIVERSITETIT TË TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 29 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.802, datë 22.7.2009 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në titull fjalët “Master në “EU Business Law”” zëvendësohen me “Master i nivelit të dytë” në “EU Business Law”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Hapjen, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, të programit të përbashkët rajonal të studimit “Master i nivelit të dytë“ në “EU Business Law”.”.

3. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Programi i studimit “Master i nivelit të dytë” në “EU Business Law” organizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është një vit përfshirë edhe mikrotezën. Në përfundim të studimeve të këtij programi lëshohet një diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “EU Business Law”.”.

4. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Në këtë program studimi të pranohen kandidatët, që kanë fituar diplomë të nivelit të dytë (DND) ose diplomë të integruar të nivelit të dytë (DIND), si dhe diploma të tjera, ekuivalente me to.”.

5. Pika 4 shfuqizohet.

6. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Tarifa e shkollimit do të jetë 100 000 (njëqind mijë) lekë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**